



Nr. 1930 Prot.

Nr. 3342 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

KOMISIONIERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
përfaqësuar nga Komisionieri, **Z. Robert GAJDA**

DHE

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
përfaqësuar nga Rektori i Universitetit, **Prof. Dr. Skënder Topi**

ELBASAN, 20 Dhjetor 2019

Komisionieri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Universiteti Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, më poshtë të quajtura “palë”,

Në mbështetje të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Nisur nga dëshira për të vendosur lidhje institucionale bashkëpunimi në interes të të dyja palëve, me qëllim promovimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, rritjen e kapaciteteve të personelit akademik dhe studentëve.

Bashkepunimin e ndërsjellë në realizimin e veprimitarise në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, ranë dakord për sa vijon:

NENI 1 OBJEKTI I MARRËVESHJES

Në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshje, palët bien dakord të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat e veprimitarise së tyre dhe për të cilat shfaqin interes të përbashkët.

NENI 2 PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Kjo marrëveshje lidhet për të lehtësuar marrëdhëniet ndërinstitucionale për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve të palëve, me synim komunikimin dhe shkëmbimin e personelit akademik, studentëve, informacioneve, ideve dhe eksperiencave që lidhen me fushat me interes të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Kjo marrëveshje shërben si bazë bashkëpunimi dhe nuk krijon të drejta ose detyrime ligjore. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në këtë marrëveshje nuk cënojnë apo ndikojnë tek të drejtat dhe detyrimet që i burojnë këtyre palëve nga kontrata/marrëveshje të tjera, apo nga legjislacioni në fuqi.
3. Palët njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit, personelit akademik dhe studentëve, bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta, në bashkërendim me ligjin, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të tyre.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të shkëmbejnë personel akademik për dhënie leksionesh të veçanta në lëndët apo modulet që ato do t'i gjykojnë me interes.

2. Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të shkëmbejnë botime akademike apo periodike.
3. Të dyja palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në kualifikimet e personelit akademik nëpërmjet organizimit të seminareve trajnuese apo udhëheqjes shkencore për përgatitje dhe mbrojtje mikrotezash, etj.
4. Personeli akademik i të dyja palëve, në varësi të interesit, do të marrin pjesë në veprimtari të përbashkëta studimore.
5. Të dyja palët do të nxisin pjesëmarrjen e personelit të tyre akademik në projekte të përbashkëta kërkimore e shkencore.
6. Të dyja palët do të informojnë njëra-tjetrën për organizimin e konferencave shkencore nga ana e tyre ose në bashkëpunim me fakultete apo institucione homologe, vendase ose të huaja dhe do të inkurajojnë pjesëmarrjen e personelit akademik në këto veprimtari.
7. Të dyja palët do të inkurajojnë reciprokisht personelin akademik për të udhëhequr studentë në tema diplomash të nivelit master e doktoraturë.
8. Të dyja palët do të krijojnë mundësi e hapësira për botime shkencore në revistat e tyre reciproke të institucioneve nga personelit akademik.
9. Të dyja palët, në kuadrin e shkëmbimit të përvojës akademike, do t'i dërgojnë njëra-tjetrës programet dhe planet e tyre mësimore, për studimet në fushat me interes të përbashkët.
10. Të dyja palët, sipas kushteve dhe mundësive, do të zhvillojnë aktivitete reciproke të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët.
11. Të dyja palët do të krijojnë mundësinë e përdorimit reciprok të bibliotekave për literaturë të paklasifikuar për pedagogët dhe studentët respektivë, si dhe të inkurajojnë përdorimin e teksteve mësimore në mënyrë të ndërsjellë.

NENI 4 **FORMAT DHE MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT**

1. Bashkëpunimi midis palëve do të realizohet me anë të aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimit të informacionit dhe botime akademike apo periodike, shkëmbimit të personelit akademik dhe studentëve.
2. Kërkesa për informacion, shkëmbim apo zhvillim të aktiviteteve të përbashkëta do t'i drejtohet palës tjetër me shkrim dhe në gjuhën shqipe.
3. Kërkesa për bashkëpunim duhet të sigurojë një përshkrim të përgjithshëm lidhur me qëllimin për të cilin kërkohet bashkëpunimi dhe kohën e dëshiruar për konkretizimin e bashkëpunimit.
4. Pala së cilës i drejtohet kërkesa, pasi e analizon atë, i siguron palës tjetër informacionin që ai zoteron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, pala së cilës i drejtohet kërkesa duhet t'i japë përgjigjen me shkrim palës që kërkon informacionin, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënen e informacionit.

NENI 5 **KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE**

1. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshjeje caktojnë nga një person kontakti/koordinator për secilin institucion.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për bashkëpunim.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e të dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

**NENI 6
DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.
2. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim.

**NENI 7
HYRJA NË FUQI**


1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe është e vlefshme për një periudhë 1 (një) vjeçare.
2. Ajo rinovalohet automatisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse, në rast se dy universitetit nuk shprehen me shkrim për të kundërtën.
3. Mosrinovimi i kësaj marrëveshjeje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga pala e interesuar të paktën 3 muaj përpërfundimit të saj.

Pasi u lexua, u gjend e rregullt dhe konformë vullnetit të të dyja palëve, marrëveshja nënshkruhet nga secila palë.

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në dy kopje origjinale, një për secilën palë.

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

**KOMISIONIER
ROBERT GAJDA**




**UNIVERSITETI ELBASANIT
“ALEKSANDËR XHUVANI”**

**REKTOR
PROF. DR. SKËNDER TOPI**

